

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë, më 23.01.2019

**VENDIM**

**Nr. 3, datë 23.01.2019**

**PËR**

**NDRYSHIM TË VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK NR. 44, DATË 05.04.2017**

Në mbështetje të shkronjës **d**, pikës **1**, neni **38** dhe neni **87** në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe për t'iu përgjigjur problematikave dhe shqetësimeve të ngritura nga studentët e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë lidhur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 44 datë 05.04.2017, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23.01.2019

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 44, datë 05.04.2017, si më poshtë vijon:

**Neni 45**

**Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies /shlyrjes së detyrimeve akademike**


1. Studimet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në të tre ciklet përkatëse, zhvillohen me bazë vitin akademik, i cili është njësia kohore bazë e studimeve.
2. Viti akademik fillon në tetor (në datën e caktuar nga MASR) dhe përfundon në 30 shtator të viti pasardhës. Viti akademik shtrihet në intervalin nga 30 deri në 42 javë mësimore, sipas udhëzimeve të MASR (28-30 javë mësim dhe deri në 10-12 javë provime dhe mbrojtje teze diplomë/provim formimi).
3. Një vit akademik organizohet në tri pjesë (veç pushimeve të verës) dhe përbëhet nga:
  - a. Semestri i Vjeshtës
  - b. Semestri i Pranverës
  - c. Sezonet e Riprovimeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

4. Organizimi i veprimtarive universitare përgjatë një viti akademik respekton urdhrin e MASR-së për strukturën e vitit akademik, aktet nënligjore në fuqi, aktet e brendshme të UV-së, si dhe shpërndarjen e detyrimeve akademike parashikuar në planin mësimor të programit të studimit sipas semestrave dhe sezoneve të riprovimeve. Studenti i vijon dhe i përfundon studimet e çdo cikli me atë plan mësimor që i ka filluar.
5. Studenti regjistrohet përgjatë vitit akademik dhe respekton organizimin e mësimdhënies, provimeve dhe riprovimeve, kohën e zhvillimit të tyre si dhe renditjen logjike të shlyerjes së provimeve, provimeve të pjesshme, praktikave profesionale, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe firmave të disiplinave mësimore, sipas projekcionit kronologjik semestral/vjetor (semestri i vjeshtës, i pranverës dhe sezonet e riprovimeve) të sanksionuar në planin mësimor të programit të studimit.
6. Provimet dhe riprovimet në të gjitha format e studimeve zhvillohen sipas afateve të caktuara në planin mësimor dhe në strukturën e vitit akademik, të miratuara nga Senati Akademik, Rektorati, dhe fakultetet dhe të pasqyruara në grafikun e provimeve.
7. Provimet dhe riprovimet në dispozicion të studentit brenda një viti akademik shtrihen dhe zhvillohen në:
  - a. në përfundim të semestrit të vjeshtës të vitit akademik,
  - b. në përfundim të semestrit të pranverës të vitit akademik,
  - c. në sezonet e riprovimeve në janar dhe shtator.
8. Datat e provimeve të pjesshme të një disipline/moduli përcaktohen brenda kohës së mësimdhënies akorduar këtyre veprimtarive universitare dhe nuk përbëjnë sezon provimi ose nuk quhen sezone të rregullta. Nuk përbën sezon provimi as një apo dy data provimesh, përpara datës së diplomimit, të cilat mund të çelen me vendimmarrjen e institucionit.
9. Datat e provimeve dhe riprovimeve propozohen nga departamenti dhe pasi miratohen nga dekani shpallen para fillimit të sezonit. Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët dhe nga studentët.
10. Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një disipline brenda të njëjtit sezon. Studentit nuk i lejohet të hyjë në provimin e një disipline nëse ai nuk ka shlyer një disipline tjetër që është kusht për të vazhduar atë disiplinë.
11. Studenti i vlerësuar jokalues në dy sezonet e rregullta të provimeve të (Vjeshtës dhe të Pranverës), ka të drejtë të përdorë të gjitha datat e shpalluara nga fakultetet në sezonet e riprovimeve, por gjithmonë duke respektuar nenet e rregullores së brendshme të UV-së që mund ta penalizojnë. Për sezonet e riprovimeve shfaqen aq data provimesh sa është numri i disiplinave në planet mësimore të vitit përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK**

12. "Student përsëritës" në kuptimin kontraktual me planin mësimor, shpallet ai student që në përfundim të vitit akademik nuk ka siguruar kreditet e nevojshme për të ndjekur semestrin e parë të vitit akademik pasardhës.
13. Për efekte juridike një student konsiderohet në vitin e dytë nëse ai ka siguruar 30-79 kredite, nëse studenti ka siguruar të paktën 80 kredite ai konsiderohet në vitin e tretë.
14. Studenti që në përfundim të provimeve semestrale apo riprovimeve ka siguruar kreditet e nevojshme ka të drejtën e regjistrimit në semestrin pasardhës.
15. Studenti përsëritës (i shpallur jokalues apo i përjashtuar nga UV për arsye të ndryshme) ka këto të drejta dhe detyrime:
  - a. I njihen të gjitha detyrimet e shlyera, kur programet e disiplinave përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim.
  - b. Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimeve që mund të jenë bërë në planin dhe programet mësimore.
  - c. Për disiplinat në të cilat ai është vlerësuar jokalues (me notë "4" ose "NP") duhet të shlyejë këto lëndë sipas planit të riprovimeve, si dhe është i detyruar të frekuentojë disiplinat për të cilat është shpallur i paklasifikuar (që nuk i ka frekuentuar asnjëherë).
  - d. Studenti me bursë humbet të drejtën e saj për vitin që përsërit.
16. Dispozitat e mësipërme vlejné për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë.
17. Këto ndryshime në rregulloren e brendshme të UV-së vlejné dhe janë në fuqi për të gjithë studentët e UV-së.
18. Problemet me tarifën e studimit të zgjidhen në marrëveshjen me studentin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
Prof. Dr. Roland ZISI**

